

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për krime të rënda- kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Tonka Berishaj dhe Vahid Halili, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arta Dumani, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R.A., për shkak të veprës penale shtytja në kryerjen e veprave terroriste nga neni 141 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe të mbrojtësit të akuzuarit av. S.M., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.68/2017, të dt.18.07.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, me datën 26.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e ankesës të Prokurorisë Speciale ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.230/2016, të dt.24.11.2016, përkritazi me vendimin për dënimin ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit R.A., për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.14.04.2017 gjerë me dt.13.07.2017, ndërsa në pjesën tjetër aktgjykimi i përmendur mbetet i pandryshuar.

II. Ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit R.A., av. S.M. refuzohet si e pabazuar .

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, P.nr.68/2017, të dt.18.07.2017, i akuzuari R.A., është shpallur fajtor për veprën penale shtytja në kryerjen e veprave terroriste nga neni 141 të KPRK, për të cilën vepër është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10(dhjetë)muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.14.04.2017 gjerë me dt.13.07.2017, e të cilin dënim do të vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës ti paguaj shumën prej 100€, kurse në emër të paushallit gjyqësor ti paguajë shumën prej 50Euro, të gjitha këto në afat prej 15(pesëmbëdhjetë)ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit. Pas shpalljes së aktgjykimit të akuzuarit i është ndërpre masa e paraburgimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim, ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj një dënim me burgim më të lartë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit R.A., av.S.M., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon ankesën e mbrojtjes, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i butë, i cili dënim do të jetë proporcional me peshën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, pasojën konkrete të saj, nivelin e përgjegjësisë për ta kuptuar veprën penale, pasi që edhe me një dënim më të butë do të arrihet qëllimi i sanksionit të tij.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, në të cilën ishin prezent mbrojtësi i të akuzuarit, av. S.M., i cili pasi që sqaroi disa nga pretendimet ankimore mbeti pranë ankesës së paraqitur me shkrim dhe i akuzuari R.A., i cili mbështeti pretendimet ankimore të mbrojtësit si në ankesën e tij. Prokurori i Apelit edhe pse i njoftuar me rregull nuk mori pjesë në seancë, prandaj seanca e kolegjit u mbajte në mungesë të tij konform nenit 390 par. 4 të KPPK.

Prokurori i Apelit të Kosovës me parashtresën PPA/I.nr.389/2017, të dt.25.08.2017, ka propozuar që të aprovet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me vendimin për dënim-sanksionin penal, në atë mënyrë që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë me burgim, ndërsa të refuzohet e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit e paraqitur lidhur me vendimin për dënim.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje penalo juridike dhe aktgjykimin e ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve ankimore, gjeti se:

Ankesa e Prokurorit është e bazuar, ndërsa ajo e mbrojtësit të akuzuarit është e pa bazuar.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal në dëm të akuzuarit, atëherë Gjykata e Apelit të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt i vlerësimit i kësaj Gjykate, ngase në këtë drejtim nuk ka pasur ankesë e as që lejohet ankesa pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë - neni 383 par. 2 të KPPK-së, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Në ankesë Prokurori thekson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë është tejet i butë dhe nuk i përgjigjet peshës së veprës penale të kryer dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit posaçërisht kur kemi parasysh faktin se veprat penale të kësaj natyre paraqesin problem aktual në tërë botën, andaj me një dënim kaq të butë nuk mund të arrihet qedhimi i dënimit për parandalimin e kryerësve dhe personave tjerë në kryerjen e këtyre veprave penale. Në ankesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, por gabimisht ka konstatuar se rrethana rënduese nuk ka gjetur edhe pse shkalla më e lartë e indoktrinimit me ideologji militante terroriste e cila e ka motivuar të akuzuarin që të shtytë kryerjen e veprave terroriste në Kosovë duhet të vlerësohet si rrethanë rënduese, si dhe fakti se i akuzuari veprën penale e ka kryer gjatë disa muajve , pikërisht deri me dt. 14 prill kur është nxënë nga policia.

Mbrojtësi i të akuzuarit me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit të akuzuarit i ka nënvlerësuar rrethanat lehtësuese të konstatuara në anën e të akuzuarit sidomos pranimin e fajësisë, nivelin e arsimimit të tij, gjendjen familjare dhe rrethanat tejet të vështirë ekonomike, pasi i njëjti është rast social dhe me familjen jeton në strehimore, mbajtës i familjes dhe i papunë, por ekzistencën e siguron me punë fizike. Pretendon se po të vlerësohen drejtë këto rrethana atëherë edhe dënimi duhet të jetë më i butë me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin në pajtim me pretendimet ankimore Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të Prokurorit për një dënim më të ashpër janë të bazuara, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit, për një dënim më të butë janë të pabazuara. Edhe pse i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka shpreh pendimin për veprën e kryer, më parë nuk ka qenë i gjykuar, është mbajtës i familjes dhe gjendjen e vështirë ekonomike, Gjykata e Apelit vlerëson se mënyra e kryerjes së veprës penale dhe përsëritja e postumeve deri sa është zbuluar nga policia tregojnë vendosmërinë e të akuzuarit për kryerjen e kësaj vepër penale , pastaj vendi dhe rrethanat nën të cilat është kryer janë të natyrës të atillë që paraqesin intensitet të rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit më të lartë ndaj të cilit me një dënim aq të butë nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Prandaj, Gjykata e Apelit e ndryshoi aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se dënimi i këtillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, si kryerës i veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të preventivës ndaj të tjerëve për të mos kryer vepër penale me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit parashikuar me nenin 41 të KPRK.

Për këto arsye ankesa e Prokurorit u aprovua si e bazuar, ndërsa pretendimet e mbrojtjes së të akuzuarit që ti shqiptohet një dënim më i butë sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, janë të pabazuara.

Nga çka u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.405/2017 me date 26.09.2017

Procesmbajtëse,

Arta Dumani

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj_____

Vahid Halili_____

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi